REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

## QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

### NJOFTIM

### APLIKIMI PËR PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2018

**Aplikimi në Portalin Matura Shtetërore 2018 do të kryhet në periudhën 26 mars-10 prill 2018,** sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

**Formulari A1** plotësohet online vetëm nga maturantët e vitit shkollor 2017-2018.

Aplikimi online me **Formularin A1** bëhet në shkollën ku maturanti vazhdon mësimin. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet "mbikëqyrës".

Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë

Web site: www.akp.gov.al

Tel/fax.+355 4 2419257

E-mail: rezana.vrapi@akp.gov.al



[Shqiptaria.com]

Faqe 1 e formularit

**Formulari A1Z** plotësohet nga:

a) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2018 dhe që kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
b) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2018 dhe që nuk kanë detyrime të Maturës Shtetërore;
c) Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, pasi kanë bërë njehsimin e diplomës në komisionin përkatës, rezultojnë se kanë ose nuk kanë detyrime të Maturës Shtetërore.

Plotësimi online i **Formularit A1Z** bëhet në shkollat ku kandidatët kanë kryer arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja e vendbanimit, nëse shkolla e mesme që kanë përfunduar është mbyllur. Kandidatët për të plotësuar formularin A1Z duhet të paraqesin tek mbikëqyrësi një kopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë/vërtetimin, me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, me fotografi/certifikatën e maturës me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, lëshuar nga drejtori i shkollës, sipas regjistrit të amzës apo dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

Procesi i plotësimit të **Formularit A1Z** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet "mbikëqyrës".

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Rezana VRAPI**

Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë

Tel/fax.+355 4 2419257

Web site: www.akp.gov.al

E-mail: rezana.vrapi@akp.gov.al



Faqe 2 e formularit

## MATURA SHTETËRORE 2018

**Aplikimi on-line i formularëve A1 dhe A1Z do të realizohet nëpër DAR/ZA sipas planit kalendar të mëposhtëm:**

| Aplikimi me Formularin A1 (Maturantët 2018) | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Datë** | **Aplikuesit në Qytetet** | | | | | | | |
| **26.03.2018** | Tirana Qytet | Tirana Qark | | | | | | |
| **27.03.2018** | Tirana Qytet | Tirana Qark | Kamëz | Kavajë | Durrës | Krujë | | |
| **28.03.2018** | Tirana Qytet | Durrës | Kavajë | Kamëz | Krujë | Elbasan | Peqin | Gramsh |
| **29.03.2018** | Elbasan | Peqin | Gramsh | Librazhd | Korçë | Pogradec | Kolonjë | Devoll |
| **30.03.2018** | Fier | Mallakastër | Lushnjë | Librazhd | Korçë | Pogradec | Kolonjë | Devoll |
| **03.04.2018** | Berat | Kuçovë | Skrapar | Fier | Mallakastër | Lushnjë | Shkodër | |
| **04.04.2018** | Shkodër | M. e Madhe | Pukë | Berat | Kuçovë | Skrapar | Kukës | Tropojë |
| **05.04.2018** | Kukës | Has | Tropojë | Lezhë | Kurbin | Mirditë | Dibër | Mat |
| **06.04.2018** | Dibër | Mat | Bulqizë | Vlorë | Sarandë | Gjirokastër | Tepelenë | Përmet |
| **10.04.2018** | Vlorë | Sarandë | Delvinë | Gjirokastër | Tepelenë | Përmet | | |


Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë

Tel/fax.+355 4 2419257

Web site: www.akp.gov.al

E-mail: rezana.vrapi@akp.gov.al





Faqe 3 e formularit

[Shqiptaria.com]

| | Aplikimi me Formularin A1Z (Maturantët përpara vitit 2018) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Datë | Aplikuesit në Qytetet | | | | | | | | | | |
| 12.04.2018 | Tirana Qytet | Tirana Qark | Durrës | Kavajë | Krujë | Kamëz | Mirditë | | | | |
| 13.04.2018 | Tirana Qytet | Tirana Qark | Dibër | Vlorë | Gjirokastër | Peqin | Gramsh | Librazhd | Sarandë | Skrapar | Përmet |
| 16.04.2018 | Elbasan | Korçë | Pogradec | Kolonjë | Devoll | Berat | Kuçovë | Kurbin | Kukës | Mat | Delvinë |
| 17.04.2018 | Fier | Mallakastër | Tepelenë | Lushnjë | Shkodër | M. Madhe | Pukë | Lezhë | Bulqizë | Has | Tropojë |

Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë
Tel/fax.+355 4 2419257
Web site: www.akp.gov.al
E-mail: rezana.vrapi@akp.gov.al



Faqe 4 e formularit